

INFORMATA MBI GRANTIN

Instrumenti:	Grant Institucional
Subjekti zbatues:	Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim (ORCA)
Kontaktet (adresa, emaili, telefoni, website):	Rr. Henrik Baric, nr.6, Prishtinë info@orca-ks.org +383 45 234 994 www.orca-ks.org
Kohëzgjatja e grantit:	Data e fillimit: 01/01/2025 Data e përfundimit: 31/12/2027
Buxheti i përgjithshëm i organizatës(EUR):	EUR 834,386.00
Buxheti i mbështetur nga programi EJA Kosovë (EUR):	EUR 119,950.00
Grupet e synuara:	<ul style="list-style-type: none">• Rinia• Studentët
Shtrirja gjeografike:	Kosovë
Përmbledhje e grantit:	<p>Me këtë projekt ORCA synon ta nxisë konkurrencën e munguar në arsimin e lartë publik dhe ta mbështesë demokratizimin e mëtutjeshëm të tij, duke sjellë inovacion në hulumtim dhe avokim publik si dhe duke fuqizuar hisedarët kryesorë të arsimit të lartë, studentët. Arsimi i lartë publik është jodinamik në zhvillimet e veta dhe në inovacion si pasojë e sigurisë financiare që ka. Fondet për universitete publike konsiderohen të sigurta. Sado që janë dizajnuar politika që financimi i univeristeteve publike të bëhet në bazë të një vlerësimi paraprak të performancës, mundësia që universitetet publike të mos financoheshin, pra të shkojnë drejt mbylljes edhe në rast të performancës së dobët është shumë e vogël, pasur parasysh sa jopopullor do të ishte vendimi edhe në qoftë meritator. ORCA propozon që përmes Platformës për Rangimin Kombëtar të Universiteteve ta nxisë konkurrencën mes universiteteve publike. Rangimi i përvitshëm i universiteteve do të shërbente si karrotë shpërblimi për ata që janë përmirësuar, në anën tjetër si shkop ndëshkimi për ata që kanë performuar dobët. Ky lloj i “kritikës” së jodrejtëpdrejtë do të ishte instrument i mirë për të mos i kontribuar kolegjeve private që duke qenë se janë biznese private dhe nuk përdorin paranë publike, mbesin jashtë domenit të kërkesës së llogaridhënies në kuptimin klasik të fjalës. Për të siguruar rritjen e vazhdueshme dhe të qëndrueshme të cilësisë në arsim duhet fuqizuar hisedarët kryesorë të arsimit të lartë, studentët. ORCA propozon që përmes aktiviteteve në Qendrën e Aktivizmit Studentor në ORCA; përmes dhënies së granteve të</p>

Bashkëfinancuar nga:



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Suedia
Sverige

	<p>vogla për grupe joformale studentore; përmes programeve edukative e rekreative jashtëkurrikulare për studentë; dhe takimin vjetor të të gjithë studentëve të angazhuar paraprakisht në Kongresin e Aktivizmit Studentor, të krijojë një trupë studentore të fuqishme, diverse, që kërkon llogaridhënie dhe transparencë e si rrjedhojë përmirëson në mënyrë të vazhdueshme cilësinë e arsimit të lartë në vend. Po ashtu, përmes këtij projekti ORCA synon transformimin e metodave të saja hulamtuese, monitoruese e avokuese duke futur në secilin dimension të përditshmërisë së saj asistencën e teknologjisë së fundit të fuqizuar nga inteligjenca artificiale me qëllim të pavarësisë së vet nga një sërë procesesh të kushtueshme dhe të ngadalshme që ulin efikasitetin e shoqërisë civile në Kosovë.</p>
--	---